



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01 Nr. 060/01-7612/26  
Kaçanik, 09.03.2026

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 09 Mars 2026 (E Hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në Sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 10:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Islam Gashi-LVV, Betim Shala-LDK, Lejla Luta-VZHK, Hafize Sallahi-AAK dhe Shemsedin Abazi-OJQ dhe Arlinda Rakoci Raka – Drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete Betim Shala.

Procesmbajtëse: Arianita Bajrami, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

**z.Betim Shala:** Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin, të pranishëm janë 4 nga 5 anëtarët për momentin dhe hapi mbledhjen e **III-të (tretë)** të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2026, data 09 Mars 2026, me këtë :

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete,
2. Gjendja e bizneseve në Komunën e Kaçanikut!
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit askush, andaj rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua nga të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

## APROVOJ

### Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete,

**Kryesuesi i Komitetit z. Betim Shala:**

Vijomë me pikën e parë të rëndit të ditës e cila është; Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete. A është në rregull me procesverbalin?

**z. Islam Gashi:** Unë nuk e votoj procesverbalin sepse nuk janë cituar të gjitha fjalët të cilat unë i kam thënë gjatë hartimit të planit.

**z. Betim Shala:** Në rregull, të tjerët a kanë diçka? Nëse jo, me shumicë votash, një kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se kjo pikë kalon!

## **2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;**

**z. Betim Shala:** Vazhdojmë me pikën e dytë e cila është; Gjendja e bizneseve në Komunën e Kacanikut. Të ftuar kemi drejtoreshën e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit znj. Arlinda Rakoci Raka e cila do të na njoftoj me gjendjen aktuale të bizneseve në komunën tonë!

Nga ky moment të pranishëm në sallë janë 5 nga 5 anëtarët!

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Unë ktu para jush kam raportin vjetor, të vitit paraprak, i cili është punu nga unë por me të dhënat nga drejtoria e kaluar.

Në kuadër të drejtorisë time është qendra komunale për regjistrimin e bizneseve, e cila vepron në funksion të biznesit lokal. Në këtë zyrë gjatë vitit 2025 janë pranuar gjithësej 563 lëndë (biznese të reja 150, shuarje të bizneseve 8, ndyshime në biznes 58, certifikatë duplikate ka qenë 19, certifikatë e re 11, informata të biznesit 312, vërtetime individuale 5 dhe kërkesa për zgjatje të orarit nuk ka pasë)

Kemi 63 biznese individuale

Biznese SHPK – 86

Biznese dega në Kosovë – 1

Biznese me pronare femra - 36

Biznese me pronarë meshkuj -114

Veprimtaritë e bizneseve të reja kanë qenë të ndryshme por më së shumti kemi pasë:

Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve, tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogël, punime suvatimi, ndërtim i objekteve banesore dhe jo banesore, etj.

Kemi nda subvencione për 18 biznese, edhe këtë vit do bëhen subvencione por akoma nuk është caktuar për cilën kategori.

**z. Betim Shala:** E shpall të hapur diskutimin mbi raportin e drejtoreshës.

**z. Islam Gashi:** Kam disa pyetje 1. Nga subvencionet apo grantet, cilat sektore po mbështeten më së shumti; 2. Grantet a ipen si fonde apo si makineri; 3. A mbështeten me grupe bizneset; 4. A mbikqyren grantet nga komuna? Dhe 5. A ka raste që një pronar biznesi të përfitoj grant dy herë?

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Më së shumti mbështeten sektorët prodhuese, grantet ipen në formë makinerish, grantet ipen me grupe si startup, ekzistuese etj., Grantet normalisht që mbikqyren nga komuna se a po përdoren, a janë ato të cilat janë marrë etj. Një përfitues i një granti mund të përfitojë grant vetëm pas një viti të plotë për të dytën herë.

**znj. Hafize Sallahu:** A ka qenë kriter që të mos fitohet subvencion nga dikush që ka fituar vitin e kaluar?

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Po, d.m.th. nuk mundesh me fitu grant herën e dytë pa kalu një vit i plotë komplet.

**z. Islam Gashi:** Unë kërkoj që ndarja e granteve të vendoset ne 3 kategori dhe një ndër to të jetë posacërisht kategoria e grave.

**Znj. Lejla Luta:** Edhe unë pajtohem.

**Znj. Hafize Sallahu:** Unë jam kategorikisht kundër kësaj kërkesë sepse gratë nuk janë për lëmshë! Unë vetë si një pronare biznesi kam mund me apliku në këto shpallje por asnjëherë s'kam apliku!

**z. Betim Shala:** Vitin e kaluar me sa di janë hap rreth 50 vende për përfitim të granteve e kanë marrë pjesë vetëm 46 aplikant.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Jo, në fakt janë nda rreth 50 mijë euro për subvencionimin e bizneseve për rreth 20 vende dhe kanë marrë subvencion vetëm 18 sepse nuk ka pasë aplikues të mjaftueshëm.

**z. Shemsedin Abazi:** E aplikuesit a kanë kriter të raportimit për financat nga subvencionet e komunës?

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Po, bëhet pasqyrimi i mjeteve, nga komisioni përkatës.

**Znj. Hafize Sallahu:** Po normal kërkojnë fatura dhe foto.

**z. Islam Gashi:** Me cilat probleme ballafaqohen kryesisht bizneset në Komunën e Kacanikut

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Për këtë pjesë sinqerisht nuk mundem me të dhanë përgjigje sepse skam informata të mjaftueshme.

**z. Betim Shala:** Mundem unë me dhanë përgjigje, në Kacanik më së shumti kemi problem klientelën sepse nuk ka mjaftueshëm fuqi blerëse.

**Znj. Hafize Sallahu:** Njejtë pajtohem edhe unë me Betimin. Por ktu e kemi një plus duke qenë se unë jam ushtruese e dy bizneseve ne Kacanik dhe në Han të Elezit, ne në Kacanik jemi të liruar nga taksat komunale te cilat i tarifohen bizneseve.

**Islam Gashi:** A ka komuna ndonjë strategji për Zhvillim Ekonomik se cilët sektor janë prioritet për vitet e ardhëshme, dhe a ka investitorë të huaj që kanë intëeresim në komunën tonë? Po sa i përket turizmit a është duke u punuar?

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Po pranin e kemi gati do vijë edhe në kuvend, dhe po kemi disa investitorë të interesuar. Sa i përket turizmit buxheti jonë edhe pse shumë i ngushtë

janë bërë investime në parkun , kioskat tash që do vendosen, shkallët tek guri i shpuar.

**znj.Hafize Sallahu:** Sa i përket shkallëve, unë desha me pyet mbi gjendjen e tyre, për dëmtimin e këtyre shkallëve.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Shkallët nuk janë të dëmtuara fare, ato janë mbulu me dhe shkak i reshjeve atmosferike, kompania e cila është përkujdesë për ndërtimin e këtyre shkallëve është angazhu që ta bëjë edhe pastrimin e tyre pasi që kemi kontratë të vlefshme akoma deri në dhjetor.

### 3.Të ndryshme;

**z.Betim Shala:** A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë po e shpall mbledhjen të përfunduar, në ora 11:07.

Procesmbajtës:  
Arianita Bajrami



Kryesues i Komitetit:  
Betim Shala